



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI**

Nr.677/1. prot

Tepelenë më , 31 .03. 2023

VENDIM

Nr.29 . datë. 29.3.2023

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE ME FOND 6% TË FONDIT TË
KUSHTËZUAR PËR MUAJIN SHKURT 2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 21 të ligjit nr 57/2019 " Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr 597 datë 04.09.2019" Për përcaktimin e procedurave , të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike " nr. 115/2021, "Per buxhetin e vitit 2022". Vendimit nr. 597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave . "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar me vendimin nr 868 date 29.12.2021;

Vendimit të Këshillit Bashkiak Tepelenë nr 4 datë 31.01.2023 "Për miratimin e kriterëve , procedurave , dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor" Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga sektori i ndihmës ekonomike në mbledhjen e datës 29.3.2023

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike 6% per muajin Shkurt 2023, 18 familje me fond **86921 lekë** , bashkëlidhur sipas tabelës .

+	EMER ATËSI MBIEMËR	NR.ANTAREVE NE FAMILJE	SHUMA
	BASHKIA E QYTETIT TEPELENË		
1	BARJAM ILJAZ KOKOTI	2	5346
2	BUJAR VESEL METO	1	2178
3	ANULA KANAN MAMA	2	3703
4	JETNOR ZYBER CUNAJ	1	2178
5	ELTON BARJAM CELA	2	3267
6	MONIKA SAFET BETA	3	7920

7	MARSELA MYZAFER ISUFI	2	3703
8	BRUNILDA MYZAFER KERI	4	10692
9	ALMIRA CETI HAZBIA	1	2178
10	ROVENA ASTRIT RACO	4	10692
11	SHPRESA SHAQO KASA	1	3146
12	BRUNILDA RIZA MAMAJ	2	3703
13	MAJLINDA EQEREM BAKO	2	3703
14	MELISA DULAJ	2	5940
SHUMA			68349
NJESIA ADM. QENDER			
1	HEDO GOXHA	3	5227
2	ANDON SHUMELI	3	5227
SHUMA			10454
NJESIA ADM. KURVELESH			
1	MARJETA VESHI	1	2178
NJESIA ADM LOPES			
1	KLODJANA ZENEL SULAJ	2	5940
SHUMA			5940
SHUMA TOTALE			86921

2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike & Menaxhimit Financiar , Drejtoria Ligjore (sektori I ndihmës ekonomike), Njësiti Administrative të Bashkisë Tepelenë për ndjekjen e këtij vendimi.

3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratur me 12(dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12(dymbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 31.03.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU

Në mungesë sips rregullore

N/KRYETAR

LUIZA SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

KËSHILLI

Nr.677/2. prot

Tepelenë më, 31.03. 2023.

VENDIM

Nr.30.datë. 29.3.2023

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TE TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN SHKURT 2023

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 21 të ligjit 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” VKM nr 597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtezuar për ndihmën ekonomike” VKB nr .95. datë 25.11.2022 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2023”, VKB nr. 4. datë. 31.01.2023 “Për miratimin e kriterëve procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtezuar mbi programin e bllok ndihmës ekonomike deri ne 6% ose me fondet e buxhetit vendor” Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 29.3.2023

VENDOSI:

1. Të trajtojë me ndihmë ekonomike 83 familje me fond 232.000 lekë muaji Shkurt 2023. Bashkëlidhur tabela.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria ekonomike & Menaxhimit Financiar Sektori i
3. Ndihmës Ekonomike dhe PAK, Drejtoria Ligjore, Njësitë Administrative të Bashkisë Tepelenë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

KRYETAR

ELVIS SHEHU

Në mungesë sips rregullore

N/KRYETAR

LUIZA SULA



Miratuar me 12(dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12(dymbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 31.03.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHIKA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.677/3.Prot

Tepelenë më, 31.03.2023



V E N D I M

Nr. 31 Datë. 23.3.2023

PËR

**MIRATIMIN E PARASHIKIMEVE AFATMESME TË TË ARDHURAVE DHE
TAVANET PËRGATITORE TË PBA 2024-2026**

Këshilli i Bashkisë Tepelenë në mbledhjen e datës 29.03.2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë « Për miratimin e parashikimeve aftamesme të të Ardhurave dhe Tavanet përgatitore të PBA 2024-2026 në mbështetje të

- Neneve 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar
- Nenit 35, të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Nenit 8, pika 8(b), dhe Nenit 27 të Ligji Nr. 10296/2010, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,
- Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”
- Udhëzimit Nr. __6__ datë 28.02.2023 të Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026
- Shkresa nr. 582. Prot date 07.03.2023 e Këshillit Bashkiak “Për rezultatet e sondazhit të komunitetit të Bashkisë Tepelenë”

V E N D O S I :

1 Të miratoj numrin maksimal të punonjësve për periudhën afatmesme 2024-2026

Nr	Emertimi	2024	2025	2026
1	Nr punonjesve	220	220	220
2	Nr punonjesve kontrate	15	15	15
3	Totali	235	235	235

2. Te miratoje parashikimet afatmesme te te Ardhurave 2024-2026

000/ leke

Nr	Emertimi I te ardhurave	2024	2025	2026
1	Te ardhura te trasheguara	2,000	2,000	2,000
2	Te ardhurat e veta	63,000	66,000	69,000
3	Transferta e pakushtezuar	105,955	113,199	121,020
4	Transferta sektoriale	100,934	100,934	100,934
	TOTALI I BUXHETIT	271,889	282,133	292,954

3. Te miratoje tavanet pergatitore te shpeznimet ne nivel programi periudha afatmesme 2024-2026

000/leke

Nr	PROGRAMI BUXHETOR	Programi Buxhetor	2024	2025	2026
1	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	O1110	103,757	106,956	107,456
2	Sherbimet e Policise Vendore	O3140	6,228	6,670	6,670
3	Fond Rezerve	O4910	5,000	5,000	5,000
4	Fond Kontigjence	O4940	5,000	5,000	5,000
5	Kujdesi social për femijet (Çerdhe)	10140	6,228	6,670	6,670
6	Sherbime publike vendore	O6260	29,464	31,111	34,694
7	Menaxhimi I mbetjeve	O5100	11,688	11,970	13,670
8	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	O8220	8,020	8,250	8,250
9	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	O9120	43,813	45,963	46,813
10	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	O9230	11,532	11,532	11,532
11	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	O4260	7,598	10,098	11,098
12	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	O4240	3,113	3,113	3,113
13	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	O3280	14,889	14,889	18,077
14	Rrjeti rrugor rural	O4520	13,059	12,411	12,411
15	Mbrojtja civile	O3280	2,500	2,500	2,500
	TOTALI I BUXHETIT		271,889	282,133	292,954

4. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar per zbatimin e ketij vendimi.

5. Ky vendim hyne ne fuqi sipas percaktimeve te nenit 55,pika 6 e ligjit nr 139/2015 « Per veteqeverisjen vendore ‘ te ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit te Qarkut Gjirokaster .

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miraturar me 12(dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12(dymbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 31.03.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU

Në mungesë sips rregullores

N/KRYETAR

LUIZA SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.677/4.Prot.

Tepelenë, më, 31/03/2023

V E N D I M

Nr.32, Datë 29/3/2023

“PËR MIRATIM E PLANIT MBROJTJES CIVILE BASHKIA TEPELENË”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjen nga zjarri dhe Shpëtimin”, Ligjit Nr.107 date 27.10.2016 “Për prefektin e qarkut”, Ligjit Nr 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materjale të shtetit”, VKM Nr, 531, datë 01.08.2003” Per Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjesitë e Shërbimit të Emergjencave Civile”, VKM Nr 532, datë 01.08.2003 “Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Departamentit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile”, VKM Nr 533, date 01.08.2003 “Për Pjesëmarrjen e Shtetasve në Parandalimin dhe Përballimin e Emergjencave Civile”, VKM Nr.664, datë 18.02.2002 “Për kriteret dhe Proçedurat e shpalljes së Gjendjes së Emergjences Civile “ VKM nr 965, datë 02.12.2015, “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”, VKM Nr.835, date 03.12.2004 “Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile”, VKM Nr 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Këshilli bashkiak :

V E N D O S I

1. Të miratoj Planin e Mbrojtjes Civile Bashkia Tepelenë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Mbrojtjes Civile në Bashki.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 12(dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12(dymbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 31.03.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU

Në mungesë sips rregullores

N/KRYETAR

LUIZA SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.677/5. prot

Tepelenë më , 31 .03. 2023



Nr.33 . datë. 29.3.2023

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT 5-VJEÇAR TË STREHIMIT 2023- 2027 TË
BASHKISË TEPELENË**

Këshilli i Bashkisë Tepelenë në mbledhjen e datës 29.3.2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë « Për miratim të programit 5-vjeçar të strehimit 2023- 2027 te Bashkisë Tepelenë " mbështetur në :

- Ligjit Nr 139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”
- Ligjit (121/2016) “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Ligjit nr. 22/2018, ‘Për Strehimin Social’ neni 68, programi lokal 5-vjeçar i strehimit
- Ligjit nr. 96/2017, neni 3, pika 2 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligjin nr.9232, “Për programet sociale të strehimit” i azhurnuar me : Ligjin Nr. 9719, datë 23.04.2007 Ligjin Nr. 54/2012, datë 10.05.2012
- V.K.M. Nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit,,;
- VKM Nr. 23, datë 07.01.2005 “Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e komitetit kombëtar të strehimit”;

V E N D O S I :

1-Të miratoje Programin 5- vjeçar të strehimit 2023- 2027 të Bashkisë Tepelenë sipas formatit bashkëlidhur.

2- Për zbatimin e Programit 5- vjeçar të strehimit ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar ,
Drejtoria e Shërbimeve Organizative dhe Drejtoria e Arsimit Sportit dhe Kujdesit Social .

3- Ky vendim hyne ne fuqi sipas percaktimeve te nenit 55,pika 6 e ligjit nr.139/2015 « Për
vetëqeverisjen vendore ‘ te ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit te
Qarkut Gjirokastrë .

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 12(dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12(dymbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 31.03.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU

Në mungesë sips rregullores

N/KRYETAR

LUIZA SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.677/6. prot

Tepelenë më , 31 .03. 2023



**MIRATIM TË PLANIT VJETOR TË KËSHILLIT RINOR TË BASHKISË TEPELENË
PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit 75/2019 “Për rininë” neni 10 pika 1 , Urdhërit nr. 98. datë 28.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë “Për krijimin e Këshillit Vendor Rinor të Bashkisë Tepelenë”, Këshilli i Bashkisë Tepelenë në mbledhjen e datës 29.03.2023, pasi shqyrtoi materialin e Drejtorisë së Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social

V E N D O S I

- 1- Miratimin e planit vjetor të Këshillit Rinor sipas formatit bashkëlidhur.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social .
- 3- Ky vendim hyne në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55,pika 6 e ligjit nr.139/2015” Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit te Qarkut Gjirokastrë .

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 12(dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12(dymbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 31.03.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU

Në mungesë sips rregullores





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr 677/7 Prot



Tepelene, me 31.3.2023

“PER MIRATIM TE OBJEKTEVE PRIORITARE TE INVESTIMEVE PER VITIN 2023”

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e tij te dates 29.3.2023 mbeshtetur ne ligjin 139/2015 “Per Vetqeverisjen Vendore” neni 54, germa “k”, relacionit te paraqitur

VENDOSI

1. Të miratojë si objekt prioritar për Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale investime në Infrastrukturë (Rrjet ujësjelles kanalizime,) për vitin 2023 , objektet si më poshtë:

- PROJEKT IDE TEPELENA NGA NJE KËND TJETËR
- INFRASTRUKTURË “FURNIZIMI ME UJË”
 - a. Ndertim të ujësjellesit të fshatit LUZAT
 - b. Rikonstruksion I rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellsit të fshatit Sinanaj dhe Dhëmban, faza II
 - c. Ndërtim I ujësjellsit të fshatit Mamaj Rrjeti i vjetër i këtyre ujësjellsave , të amortizuar dhe me probleme të shumta . Humbjet në rrjet janë të mëdha, depo e ujit dhe ajo e amortizuar pavarësisht ndërhyrjeve për gjatë viteve
- INFRASTRUKTURE RIKUALIFIKIME TË QENDRAVE TË BANUARA
 - a. Rikualifikim urban I qendrave të lagjes GURRËZ
 - b. Sistemit I zonës së majkoshit
- INFRASTRUKTURË ZHVILLIMIN BUIQËSOR
 - Rikonstruksion lera dhe permiresim të kullotes
 - Rikonstruksion kanle ujitës fshati Turan

3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës, plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme në aplikimin e projekteve sipas thirrjeve ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit,



4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Jurist

Julinda Karteri

KRYETAR

Elvis Shehu

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona Çela

Miratur me 12 vota

Vota Pro 12

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 31.03.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.677/8. prot

Tepelenë më , 31 .03. 2023

VENDIM

Nr.36 . datë. 29.3.2023

PËR DHËNIE TITULL NDERI

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 29/03./2023 , në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 54 pika “m” ; Ligjit 112/2013 “Për dekoratat , titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit të RSH” pasi shqyrtoi materialin e Komisionit Këshillimor të Bashkisë Tepelenë

V E N D O S I

A. Të miratojë dhënien e titujve të nderit si më poshtë:

- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” **Z. Luan Ziflo** me motivacionin :” *Për përkushtimin maksimal në misionin ushtarak në mbrojtje të idealeve të atdheut,intelektual dhe qytetar me virtyte të larta në Tepelenë dhe më gjerë*”.

B. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social.

C. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratur me 12(dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12(dymbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 31.03.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU

Në mungesë sips rregullore

N/KRYETAR

LUIZA SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr. 677₉ prot.

Tepelenë, më 31 . 03 . 2023

VENDIM

Nr. 37, datë 29 . 3 . 2023

PËR

MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES NË REALIZIMIN E PROJEKTIT “OBJEKT 2KT MBI TOKË DHE 2KT NËNTOKË”, NDODHUR FSHATIN HORMOVË, ZONA KADASTRALE NR. 1961, PASURIA NR. 55/3, ME ZHVILLUES/INVESTITOR SUBJEKTIN “RIVER DRINO RESORT” SHPK ME NIPT M38817501R

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, e ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 11.07.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-Leje)”; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, të ndryshuar; Dokumenteve të paraqitura, si dhe Propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tepelenë,

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të marrëveshjes në realizimin e projektit “Objekt 2kt mbi tokë dhe 2kt. nëntokë”, ndodhur fshatin Hormovë, Zona Kadastrale nr. 1961, Pasuria nr. 55/3, me Zhvillues/Investitor subjektin “River Drino Resort” shpk me NIPT M38817501R.
2. Miratimin për nënshkrimin e Aktmarrëveshjes ndërmjet Bashkisë Tepelenë, me Pronarin e pronës private dhe subjektin zhvillues (bashkëlidhur këtij vendimi).

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për
“Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratur me 12(dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12(dymbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 31.03.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU

Në mungesë sips rregullores

N/KRYETAR

LUIZA SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
TEPELENË

Nr.677/10prot.

Tepelenë më, 31.03. 2023

V E N D I M

Nr.38. Datë.29.03.2023

“Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor ndodhur në Bashkinë Tepelenë”

Në mbështetje të nenit 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” dhe të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, ligjit nr.139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”; ligjit 115/2014 “Per ndarjen administrativo territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar; ligjit nr.8743 date 22.02.2001 “Per pronat e paluajtshme te shtetit” ligjit 57/2020 “Për pyjet; ligjit nr.9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” te ndryshuar; Udhezimit nr.1 date 9.6.2016 te Ministrit te Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik”; Udhezimit te Ministrit te Mjedisit nr.2 date 20.7.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”; mbështetur në të dhënat e certifikatave të pasurive rezulton që sipërfaqet e kërkuara bëjnë pjesë në njësitë administrative Kurvelesh, Lopës, Qendër dhe Tepelenë, inventarit të pasurive;

V E N D O S I:

1. Te jape pelqimin ne parim per dhenien me qira/ne perdorim per pasurite e Bashkise Tepelene te llojit pyll, kullote dhe inproduktive sipas listes se inventarit te miratuar me VKM nr.433/2016 te ndryshuar me VKM nr.398 date 13.5.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të këshillit të ministrave, “për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, sipas funksionit dhe destinacionit që kanë.
2. Këto pasuri bëjnë pjesë në territorin e Bashkisë Tepelenë në Ekonomitë Kullosore Kurvelesh, Sinanaj, Qendër dhe Dukaj-Luzat, dhe në Ekonomitë Pyjore Kurvelesh, Sinanaj, Dragot dhe Dukaj-Luzat.
- Të dhënat e pasurive jane sipas tabelës së inventarit bashkelidhur ketij vendimi.
3. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik dhe elementeve të tij, në mbështetje të Udhezimit te Ministrit te Mjedisit nr.2 date 20.7.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”; Udhezimit nr.1 date 9.6.2016 te Ministrit te Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne

- perdorim te fondit pyjor dhe kullor publik”; si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit kullor/pyjor.
4. Para fillimit të procedurave të konkurimit Bashkia Tepelenë duhet të pajiset me certifikatë pronësie nga ASHK për çdo pasuri e cila është pjesë e inventarit bashkëlidhur këtij vendimi, VKM 398 date 13.5.2020, dhe të miratohet Plani i Mbarështimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës, plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme në përputhje me përcaktimet e Udhezimit të Ministrit të Mjedisit nr.2 date 20.7.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”; Udhezimit nr.1 date 9.6.2016 të Ministrit të Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullor publik”; ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Qiradhënies së Pyjeve e Kullotave publike.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 12(dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12(dymbëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 31.03.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU

Në mungesë sips rregullores

N/KRYETAR

LUIZA SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
TEPELENË

Nr.677/11 prot.

Tepelenë më, 31.03.2023

V E N D I M

Nr.39, Datë 29.03.2023

“Për miratimin e listës me sipërfaqet e tokave bujqësore sipas inventarit për tu dhënë me qera, ndodhur në Bashkinë Tepelenë”

Në mbështetje të nenit 8 “Ushtimi i autoritetit me interes publik vendor” dhe të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”; neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”; neni 3 i ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara”; VKM nr.843 datë 6.12.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Qendër Tepelenë, të Qarkut Gjirokastrë”, VKM nr.386 datë 25.05.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të transferimit në pronësi ose përdorim të pasurive të komunës Kurvelesh Tepelenë, të Qarkut Gjirokastrë”, VKM nr.380 datë 8.4.2009 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose përdorim, të komunës Lopës, të Qarkut të Gjirokastrës”; si dhe pika 5 dhe 11 e Udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 “Për shfuqizimin e udhëzimit nr.3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”; VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” te ndryshuar; Udhëzim Nr. 13, datë 26.4.2018 “Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; mbështetur në të dhënat e certifikatave të pasurive rezulton që sipërfaqet e kërkuara bëjnë pjesë në njësitë administrative Lopës, Kurvelesh dhe Qendër; inventarit të pasurive.



VENDOSI:

1. Për miratimin e listës me sipërfaqet e tokave bujqësore për tu dhënë me qira, sipas funksionit dhe destinacionit që kanë sipas listave të inventarit të miratuara me VKM sipas Njësive Administrative dhe fshatrave:
- Sipas VKM nr.380 datë 8.4.2009 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose përdorim, të komunës Lopës, të Qarkut të Gjirokastrës" sipërfaqet e llojeve "Arë", "Pemtore", "Vresht", dhe "Pa Frut" për fshatrat Dorëz, Matohasanaj, Sinanaj, Dhëmban dhe Lab-Martalloz .
 - Sipas VKM nr.386 datë 25.05.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të transferimit në pronësi ose përdorim të pasurive të komunës Kurvelesh Tepelenë, të Qarkut Gjirokastrë" sipërfaqet e llojeve "Arë", "Pemtore" dhe "Pa Frut" për fshatrat Nivicë, Rexhin, Gusmar, Progonat dhe Lekdush.
 - Sipas VKM nr.843 datë 6.12.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Qendër Tepelenë, të Qarkut Gjirokastrë" sipërfaqet e llojeve "Arë" dhe "Pemtore" për fshatrat Luzat, Veliqot, Mezhgoran, Peshtan, Turan, Mamaj, Bënçë, Salari, Dragot, Kodër, Beçisht, Hormovë dhe Dukaj.

Të dhënat e tokave bujqësore sipas tabelës së mëposhme:

Nr	Nj.A. Lopës/fshati	Zona kadastrale	Lloji i pasurie	Sipërfaqe m ²
1	Dorëz	1518	Arë	234790
			Pemtore	34832
			Ullishte	4600
			Pa Frut	230710
2	Matohasanaj	2613	Arë	330080
			Pemtore	53010
			Ullishte	2200
			Pa Frut	67812
3	Sinanaj	3452	Arë	831712
			Pemtore	227363
			Vresht	3100
			Ullishte	67323
4	Dhëmban	1480	Pa Frut	377300
			Arë	729016
			Pemtore	560407
			Vresht	90970
			Pa Frut	46993
			Arë	266920
			Pemtore	45363



Lab-Martalloz		2361	Ullishte	3400
			Pa Frut	2357107
Nr	Nj.A. Kurvelesh/fshati	Zona kadastrale	Lloji i pasurie	Sipërfaqe ha
1	Nivicë	2807	Arë	194
			Pemtore	10.7
			Pa Frut	413
2	Rexhin	3177	Arë	77.2
			Pemtore	0.7
			Pa Frut	1.6
3	Gusmar	1913	Arë	143
			Pemtore	14.9
			Pa Frut	230
4	Progonat	3057	Arë	150.1
			Pemtore	3.7
			Pa Frut	249.6
5	Lekdush	2404	Arë	67.5
			Pemtore	5.2
			Pa Frut	530.7

Nr	Nj.A. Qendër/fshati	Zona kadastrale	Lloji i pasurie	Sipërfaqe m ²
